



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1366/3 Prot.

Tiranë, më 24/11 /2017

VENDIM

Nr. 97, datë 24/11 /2017

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/I të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, shoqëria SIRETA 2F Sh.p.k, me administratore Znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankimin nr. 1366 Prot., datë 16.10.2017 kundër Autoritetit Publik “Bashkia Sarandë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi nëpërmjet kërkesës së datës 02.09.2017, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me:

1. *Kopje të Raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit ku evidentohet debia e shoqërisë;*
2. *Kopje të faturës Nr. 70 datë 17.11.2014, nga e cila shoqëria rezulton debitore;*
3. *Kopje të dokumentacionit që përmban dosja lidhur me objektin “Rrethimi i Varrezave Ksamil”.*

Ankuesi pretendon se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur ankesës rezulton se Autoriteti Publik nuk i ka kthyer përgjigje kërkuarit.

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik, ankuesi kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Me shkresën nr. 1366/1 datë 18.10.2017, Komisioneri ka kërkuar të trajtohet kërkesa dhe të vlerësohet dhënia e informacionit brenda datës 25.10.2017.

Me shkresën 3671/1Prof., datë 13.11.2017, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje, duke vënë në dijeni Zyrën e Komisionerit, shkresë në të cilën citohet dokumentacioni që i është vënë në dispozicion kërkuarit.

Pas marrjes së përgjigjes, ankuesi ka kontaktuar Zyrën e Komisionerit me pretendimin se nuk ka marrë Kopjen e Raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilin e ka kërkuar në pikën e parë të kërkesës së tij.

Pas shqyrtimit të ankesës, kërkesës për parashtrime, si dhe konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili përcakton se: “Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloji forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Autoriteti detyrohet të informojë kërkuarin në përputhje me objektin e tij të kërkesës duke vënë në dispozicion kopje të plotë të informacionit të kërkuar.

Për sa më sipër, konstatohet se Autoriteti Publik nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në nenin 15 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim quajtur “Ligji për të Drejtën e Informimit”).

Bazuar në nenin 15 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit, Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Bazuar në pikën 1 të nenit 14 të po këtij ligji parashikohet se “Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet”.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkesat e sipërcituara përfshihen në kategoritë e informacionit që kërkohen në Programin e Transparencës së Autoritetit Publik si dhe t’i vihen në dispozicion publikut pa kërkesë, jo vetëm në faqen zyrtare por edhe në mjediset e zyrave të tij.

Konkretisht, informacioni lidhur me Kopjen e Raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, është një informacion publik i cili disponohet nga Autoriteti Publik, për vetë faktin se ky

i fundit në kuadër të detyrimit për informim, në përputhje me përcaktimin e pikës dh) të nenit 7 të ligjit, Autoritetet Publike vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit.

Përfundimisht, konstatohet se Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur detyrimin për të informuar kërkuesin.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Shoqërisë SIRETA 2F Sh.p.k, ndaj Autoritetit Publik, Bashkisë Sarandë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5, të nenit 24, nenit 25, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18, të ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative", dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1366 datë 16.10.2017 së shoqërisë SIRETA 2F Sh.p.k ndaj Autoritetit Publik, Bashkisë Sarandë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, Bashkia Sarandë, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, konkretisht:
  - Kopje të Raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda datës 07.12.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot me datë 24.11.2017.

